

Thirrje për aplikime

#GO2Innovation njofton hapjen e Thirrjes për aplikime për sipërmarrësit në turizëm dhe agrobiznes në Qarkun Shkodër. Përmes kësaj thirrjeje ftohen të gjithë sipërmarrësit që operojnë në sektorët e turizmit dhe agrobiznesit, që brenda datës **11 Mars 2020, ora 14.00**, të aplikojnë pranë Qendrës së Inovacionit #GO2Innovation për të marrë shërbimet e mëposhtme:

- Hapësirë e përbashkët pune për sipërmarrësit fillestarë
- Këshillim mbi ngritjen e një sipërmarrjeje të re
- Rrjetëzim me sipërmarrje, institucione publike, shkolla profesionale,
- Këshillim për risitë në turizëm dhe teknologjitë e pastra
- Aftësim për artizanat, gastronomi, akomodim, guida, punime arti, agroturizëm, bujqësi, blegtori, etj
- Edukim ligjor dhe financiar për sipërmarrjet
- Hartim plan-biznesi për sipërmarrjet
- Mbështetje për rritje fondesh përmes aplikimeve të ndryshme
- Praktika pune të studentëve të shkollave profesionale/universitetit pranë sipërmarrjeve
- Zhvillim shërbimi/produkti turistik dhe agrobiznesi
- Marketim online dhe offline për shërbimet/produktet turistike
- Promovim në media vendase dhe të huaja përmes vizitave të gazetarëve pranë sipërmarrjeve
- Pjesëmarrje në panaire dhe konferenca rajonale të turizmit dhe agrobiznesit
- Çertifikim i shërbimeve/produkteve turistike

Aplikimi mund të bëhet përmes plotësimit të formularit online në këtë link:

<https://forms.gle/HJpcJyeqqWPYguin7>

ose duke tërhequr formularin e aplikimit pranë qendrave të #GO2Innovation në adresat e mëposhtme:

turizëm
dhe
agrobiznes

hapësirë
bashkëpunuese
rrjetëzim
edukim
këshillim
aftësim
marketim
çertifikim

EU for Innovation



#GO2Innovation

GO2 Albania
Blvd "Skënderbeu"
Nd 34, H2, A1
4001 Shkodër

#GO2Innovation

Shkolla Profesionale "Hamdi Bushati"
Rr. Hysen Lohja
Nd 33, Nr 1
4001, Shkodër

#GO2Innovation

Njësia Administrative Bushat
Rr. Qendër Bushat
Nr 168
4008 Vau Dejës

Aplikimet duhet të plotësohen online, ose të dorëzohen fizikisht brenda afatit të caktuar në njërin prej adresave të mësipërme.

Përzgjedhja e sipërmarrjeve do të bëhet përmes dy fazave. Faza e parë është aplikimi, i cili do të vlerësohet nga një juri ekspertësh të #GO2Innovation, sipas pikëve të përcaktuara në formatin e aplikimit. Ndërsa faza e dytë është përmes një interviste me gojë në njërin prej qendrave të #GO2Innovation.

Aplikantët do të njoftohen përmes telefonit dhe emailit për ecurinë e përzgjedhjes së aplikimit, si dhe për mbajtjen e intervistës.

#GO2Innovation ju uron suksese të gjithë sipërmarrësve!



#GO2Innovation
+355696728877
innovation@go2albania.org
www.go2albania.org/rbita

#GO2Innovation Centre është një sipërmarrje policentrike partneriteti e drejtuar nga Organizata GO2 në bashkëpunim me Shkollën Profesionale "Hamdi Bushati" dhe Bashkinë Vau Dejës dhe me 3 qendra në institucionet e mësipërme. #GO2Innovation mbështetet nga programi EU for Innovation i financuar nga Bashkimi European dhe i zbatuar nga SIDA dhe GIZ.

hapësirë
këpunuese
rjetëzim
edukim
shillim
aftësim
marketim
çertifikim